

(MOS) ZBATIMI I LIGJIT PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE NË NIVELIN EKZEKUTIV





Instituti Demokratik I Kosovës është degë e
Transparency International për Kosovë

Misioni i KDI-së është mbështetja e
zhvillimit të demokracisë pjesëmarrëse
dhe luftës kundër korrupsion përmes
promovimit të transparencës,
llogaridhënies dhe integritetit në të
gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë

COPYRIGHT © 2023. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdorë citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 239

10 000, Prishtinë, Kosovë.

Tel: +383 (0) 38 248 038

E-mail: info@kdi-kosova.org

Ueb: www.kdi-kosova.org

Autorë: **Albesa Humolli**

Layout and design: **envinion**

PËRMBAJTJA

06

Lista e shkurtesave

07

METODOLOGJIA

09

1. PËR SINJALIZIMIN

10

2. SI MBROHEN SINJALIZUESIT
NË KOSOVË

13

ZBATIMI I LIGJIT PËR SINJALIZIM
NË DIKASTERET E QEVERISË

14

I. MOS-PUBLIKIMI I EMRAVE TË
ZYRTARËVE PËRGJEGJËS PËR
SINJALIZIM

15

II. MOS-SHTRIRJA E
INFORMATËS PËR PUNONJËSIT
E INSTITUCIONEVE MBI
MUNDËSINË E SINJALIZIMIT

16

III. MUNGESA E KUSHTEVE
TEKNIKE PËR TË SINJALIZUAR
BRENDA INSTITUCIONEVE

17

IV. ZYRTARËT PËR SINJALIZIM
KANË KALUAR VETËM NË
TRAJNIME BAZIKE

18

V. MUNGESA E PËRKRAHJES
INSTITUCIONALE PËR ZYRTARËT
PËRGJEGJËS PËR SINJALIZIM

19

VI. PUNË SHITESË PA PAGESË

20

VII. MUNGESA E RASTEVE TË
SINJALIZIMIT NË INSTITUCIONE
NDONËSE PARREGULLSITË JANË
EVIDENTE

21

REKOMANDIMET



LISTA E SHKURTESAVE

LMI - Ligji për Mbrojtjen e Informatorëve

LMS - Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve

RREGULLORJA - Rregullorja Nr. 03/2021 Për Përcaktimin e Procedurës për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit (Rregullorja)

UDHËZUESI MBI HETIMIN ADMINISTRATIV - Udhëzues për Mënyrën e Kryerjes së Hetimit Administrativ, miratuar nga Ministria e Drejtësisë, me Vendimin Nr. 158/2023, me datë 18.07.2023

UDHËZUESI PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE - Udhëzues për mbrojtjen e personave që raportojnë në interes publik, detyrimet e punëdhënësve për mbrojtjen e sinjalizuesve nga aktet e dëmshme dhe të drejtat e sinjalizuesve për mbrojtje gjyqësore, miratuar nga Ministria e Drejtësisë, me Vendimin Nr. 179/2023, me datë 19.09.2023

APK - Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit

IP - Inspektorati i Punës

ZKM - Zyra e Kryeministrit

MPJD - Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës

MFPT - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

MD - Ministria e Drejtësisë

MM - Ministria e Mbrojtjes

MPBAP - Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike

MSH - Ministria e Shëndetësisë

MASHTI - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)

MKRS - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MMPHI - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

MBPZHR - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

MINT - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

ME - Ministria e Ekonomisë

MZHR - Ministria për Zhvillim Rajonal

MKK - Ministria për Komunitete dhe Kthim



METODOLOGJIA

Analiza mbi zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve (LMS) në Qeverinë e Kosovës është hulumtimi i dytë në kuadër të ciklit të hulumtimeve të KDI-së mbi zbatueshmërinë e këtij ligji në sektorin publik dhe atë privat dhe pason analizën që është bërë në vitin 2022 mbi zbatimin e LMS në sektorin e drejtësisë. Gjatë vitit 2024, KDI pritet vazhdojë me monitorimin e këtij ligje si dhe do të pasojnë hulumtime të ngjashme për sektorët e tjerë si qeverisja lokale, ndërmarrjet publike dhe sektori privat.

Për qëllim të këtij hulumtimi, KDI ka shqyrtuar kornizën ligjore që rregullon çështjen e sinjalizimit në Kosovë, përfshirë Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Rregulloren përkatëse për zbatimin e këtij ligji si dhe dy udhëzues të aprovuar nga Ministria e Drejtësisë (MD) përgjatë këtij viti në lidhje me mënyrën e kryerjes së hetimit administrativ si dhe mbrojtjes së personave që raportojnë në interes publik. Legjislacioni aktual përcakton një sërë obligimesh për institucionet, që lidhet me mënyrën e garantimit të sinjalizimit si mekanizëm parandalues i korrupsionit dhe formën e trajtimit të tyre.

Përveç analizës së kornizës ligjore, KDI, për realizimin e këtij hulumtimi ka përdorur edhe metodën e intervistës. Me qëllim të ofrimit të një pasqyre gjithëpërfshirëse mbi zbatueshmërinë e LMS në nivel të qeverisë, KDI përgjatë shtatorit të 2023, u është drejtuar me kërkesë për intervistë, Zyrës së Kryeministrit si dhe pesëmbëdhjetë (15) ministrive përkatëse, duke përfshirë Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD); Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT); Ministrinë e Drejtësisë (MD); Ministrinë e Mbrojtjes (MM); Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike (MPBAP); Ministrinë e Shëndetësisë (MSH); Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI); Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS); Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL); Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI); Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR); Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT); Ministrinë e Ekonomisë (ME); Ministrinë për Zhvillim Rajonal (MZHR) dhe Ministrinë për Komunitete dhe Kthim (MKK).

Përgjatë hulumtimit, fillimisht mbledhjes së informatave për zyrtarët përgjegjës për sinjalizim në institucionet në nivelin ekzekutiv si dhe realizimit të intervistave me ta, KDI në disa raste ka hasur në vështirësi në lidhje me marrjen e informatave (kontakteve) të zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim për shkak të mospublikimit të të dhënave të zyrtarëve nga ana e institucioneve, por gjithashtu ka hasur edhe në raste kur zyrtarët fillimisht kanë hezituar të deklarohen në lidhje me institucionin që ata përfaqësojnë.

Nga gjashtëmbëdhjetë (16) institucione në tërësi të cilave KDI u është drejtuar me kërkesë për intervistë, janë realizuar gjithsej katërmëdhjetë (14) intervista me zyrtarët përgjegjës për sinjalizim. Shumica e intervistave, gjithsej njëmbëdhjetë (11) prej tyre janë zhvilluar fizikisht, ndërsa në tre (3) raste zyrtarët kanë preferuar që intervistën të zhvillojë përmes komunikimit elektronik - email. Përkundër disponimit pozitiv të zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim për t'u intervistuar nga KDI, të njëjtit kanë hezituar fillimisht që të deklarohen për pozitën që mbajnë. Nga gjithsej gjashtëmbëdhjetë (16) kërkesa për intervista, KDI ka marrë përgjigje refuzuese apo nuk ka marrë përgjigje fare nga shtatë (7) zyrtarë. Vetëm pas insistimit të dytë (ri-dërgimit të ftesave apo kontaktit të zyrtarëve përmes telefonit), KDI ka arritur të realizojë intervista edhe me pesë (5) zyrtarë. Ndërsa dy (2) nga 16 zyrtarët e kontaktuar nuk kanë pranuar fare të deklarohen. Intervistat janë zhvilluar gjatë periudhës shtator – tetor 2023.



Sinjalizimi është
mekanizmi për të
dhënë “informacionin
e duhur” tek “njerëzit
e duhur”





1. PËR SINJALIZIMIN

Sinjalizimi është mjet i rëndësishëm në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit sepse inkurajon qytetarët të kontribuojnë për të mirën e përgjithshme publike duke denoncuar keqpërdorimet që mund të ndodhin në institucionet publike e private, por edhe në shoqëri. Nëpërmjet sinjalizimit, një individ ka mundësinë që të raportojë apo zbulojë informata lidhur me veprimet që ndodhin në vendin e tij të punës, e të cilat cenojnë interesin publik. Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve (LMS), përcakton që sinjalizues është çdo person i cili raporton ose shpalos informacione për një kërcënim ose cenim të interesit publik në kontekstin e marrëdhënies së vet të punës në sektorin publik ose privat.¹

Elementet e para të konceptit të sinjalizimit në botë, fillimisht i hasim në Anglinë e shekullit të XII, ku mbreti kishte vendosur se kushdo që raporton një keqbërje do të shpërblehej. Kjo deklaratë përfaqësoje shembullin e parë të një ligji që lejon individët privatë të mbledhin një shpërblim për raportimin e një shkeljeje të legjislacionit të vendit të tyre.² Më shumë statute të ngjashme u ngritën gjatë shekujve të ardhshëm edhe në shumë vende tjera për shkak të efektivitetit “të shpërblimit” në nxitjen e qytetarëve për të raportuar shkelësit e ligjit.

Në këtë drejtim, sinjalizimi si koncept është përqafuar dhe zhvilluar edhe në kulturën dhe politikën amerikane. Që nga themelimi i saj, Amerika ka nxitur dhe përqafuar një kulturë të përgjegjësisë qytetare për të mbrojtur të mirën publike. Benjamin Franklin u bë një nga sinjalizuesit e parë amerikanë kur në vitin 1773, ekspozoi letrat konfidenciale që tregonin se guvernatori i Massachusetts kishte mashtruar qëllimisht parlamentin për të promovuar një ngritje ushtarake në kolonitë amerikane.³

Gjatë viteve të fundit, Bashkimi Evropian (BE) ka ndërmarrë hapa për të forcuar të drejtat e sinjalizuesve, ndërsa në vitin 2019 miratoi edhe direktivën e re për “Mbrojtjen e personave që raportojnë për shkelje të ligjeve të Unionit” (Direktiva për Mbrojtjen e Sinjalizuesve). Kjo direktivë shënon hapin e parë të BE-së drejtë unifikimit të politikave në çështjen e mbrojtjes së sinjalizuesve dhe për më tepër është hera e parë që BE ka një legjislacion të dedikuar në këtë fushë. Nëpërmjet kësaj direktive sigurohet mbrojtje më e madhe për sinjalizuesit dhe mbrojtje nga hakmarrja nëpërmjet krijimit të “kanale të sigurta” për të raportuar shkeljet e ligjit. Të gjitha vendet anëtare të BE-së duhet ta transpozojnë direktivën në legjislacionin e tyre kombëtar deri në dhjetor 2021. Megjithatë, shtetet e BE-së inkurajohen të miratojnë mbrojtje dhe stimuj më të mëdhenj për sinjalizuesit përtej standardit minimal të përcaktuar nga direktiva.

1 Neni 3, par.1.1, i Ligjit nr. 06/L -085 për mbrojtjen e sinjalizuesve

2 Whistleblowers History Overview, Whistleblowers International, e qasshme në <https://www.whistleblowersinternational.com/what-is-whistleblowing/history/>

3 Po aty.





2. SI MBROHEN SINJALIZUESIT NË KOSOVË

Sinjalizimi për herë të parë në Kosovë është rregulluar me Ligjin për Mbrojtjen e Informatorëve (LMI) të vitit 2011, ligj ky i cili përmbante 11 nene dhe synonte të përcaktojë procedurën e raportimit, trajtimit dhe mbrojtjes së informatorëve.⁴ Por dispozitat dhe fushë-veprimtaria e këtij ligji ishte tejet gjenerale dhe si e tillë vështirë e zbatueshme si për subjektet informuese ashtu edhe për autoritetet që pranonin këto informata. Ndonëse ky ligj ishte mirëpritur nga shoqëria civile për risitë që kishte sjellë në fushën e mbrojtjes së lirisë së shprehjes dhe zbulimit të informatave me interes publik, ishte kritikuar meqë nuk inkurajonte “informatorët” për të sinjalizuar dhe gjithashtu ishte edhe në shpërputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e sinjalizuesve.

Kësisoj, për shkak të metave të shumta që kishte LMI, më 2 janar të vitit 2019 hyn në fuqi Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve (LMS), që shënon hapin e parë drejt krijimit të një kornize të konsoliduar ligjore në harmoni edhe me Direktivën Evropiane për sa i përket mbrojtjes së sinjalizuesve. Ky ligj për dallim nga ligji i mëhershëm (LMI) përcakton se sinjalizuesit që raportojnë apo shpalosin informacione nuk janë të obliguar të dëshmojnë mirëbesimin dhe vërtetësinë e raportimit të tij si dhe mundëson sinjalizimin e shkeljeve si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat⁵. LMS për më tepër përfshin edhe dispozita ligjore me të cilat rregullohet procedura e sinjalizimit, të drejtat dhe mbrojtja e sinjalizuesve, përfshirë mbrojtja gjyqësore e sinjalizuesve. LMS ka paraparë që organet kompetente për sinjalizimin e jashtëm janë Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) për sektorin publik, dhe Inspektorati i Punës (IP)

për sektorin privat sipas fushave të përgjegjesisë. LMS gjithashtu parasheh që APK monitoron zbatimin e këtij ligji dhe është përgjegjëse edhe për promovimin e sinjalizimit dhe mbajtjen e trajnimeve. Obligim tjetër i APK-së sipas LMS-së, është hartimi i raportit vjetor për sinjalizim që çdo vit duhet të publikohet deri më 31 janar për vitin paraprak⁶ mbi bazën e raporteve që subjektet publike apo private kanë dorëzuar në APK.⁷

4 Ligji nr. 04/L-043 për mbrojtjen e informatorëve

5 Neni 1, i Ligjit nr. 06/L -085 për mbrojtjen e sinjalizuesve

6 Po aty.

7 Po aty, Neni 29





Në bazë të LMS-së, sinjalizimi në Kosovë mund të bëhet në tre mënyra:

- Sinjalizim i brendshëm - nënkupton raportimin brenda institucionit publik apo subjektit privat;
- Sinjalizim i jashtëm - nënkupton raportimin tek Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit
- Sinjalizim publik, nënkupton shpalosja e informacionit në media, tek organizatat joqeveritare, përmes internetit, në një mbledhje publike, ose në ndonjë mënyrë tjetër

Korniza ligjore mbi mbrojtjen e sinjalizuesve është zgjeruar tutje në vitin 2021, me miratimin Rregullores Nr. 03/2021 për Përcaktimin e Procedurës për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit (Rregullorja) me të cilën përcaktohen rregullat si dhe procedurat për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve përgjegjës. Kjo rregullore ka përcaktuar më në detaje obligimet e institucionit për caktimin e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim si dhe obligimet në lidhje me sigurimin e burimeve të mjaftueshme për zyrtarin në përmbushjen e detyrave të tij si: hapësirë dhe pajisje për punë, kushte të përshtatshme për ruajtjen e dokumenteve e të tjera.⁸ Sipas kësaj rregullore duhet të bëhet mbrojtja e raportimit si dhe zyrtarët përgjegjës kanë për detyrë të pranojnë dhe trajtojnë raportimet, të kryejnë hetimin administrativ në lidhje me raportimin, të përgatisin raporte në baza vjetore në lidhje me rastet e pranuar të sinjalizimit, të cilat me pas dërgohen në APK.⁹

Përditësimi i kornizës ligjore për mbrojtjen e sinjalizuesve gjatë vitit 2023

Gjatë vitit 2023, korniza ligjore që rregullon mbrojtjen e personave që raportojnë në interes publik është zgjeruar edhe me dy udhëzues të ri që rregullojnë në detaje çështjen e hetimit administrativ dhe mbrojtjes së personave që raportojnë në interes publik. Miratimi i këtyre udhëzuesve vjen pothuajse dy vite me vonesë, nga miratimi i rregullores, përkundër nevojës dhe presionit ndaj MD dhe APK për të përfunduar punën rreth këtyre udhëzuesve.

Udhëzuesi i parë mbi mënyrën e kryerjes së hetimit administrativ¹⁰ është miratuar nga MD në korrik të këtij viti. Ky udhëzues përmban udhëzime mbi procedurën që duhet ndjekur dhe mjetet që zyrtari përgjegjës ka në dispozicion me rastin e zhvillimit të një procedure të hetimit administrativ, duke përfshirë parimet mbi të cilat zhvillohet hetimi administrativ, hapat për trajtimin e rasteve të sinjalizimit, regjistrimin e raportimit, mbajtjen e regjistrit, kryerjen e hetimit administrativ, të drejtat e palëve pjesëmarrëse, veprimet pas hetimit administrativ si dhe përcakton edhe forma të shkresave që duhet të përdoren nga zyrtari përgjegjës gjatë hetimit administrativ.

8 Neni 5, par.9, i Rregullores nr. 03/2021 për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit

9 Neni 16, i Rregullores nr. 03/2021 për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit

10 Udhëzuesi mbi mënyrën e kryerjes së hetimit administrativ është miratuar nga Ministria e Drejtësisë, me Vendimin Nr. 158/2023 me datë 18.07.2023



Ndërsa udhëzuesi i dytë mbi mbrojtjen e personave që raportojnë në interes publik, detyrimet e punëdhënësve për mbrojtjen e sinjalizuesve nga aktet e dëmshme dhe të drejtat e sinjalizuesve për mbrojtje gjyqësore¹¹ i miratuar në shtator të këtij viti, përmban udhëzime mbi mbrojtjen e sinjalizuesve nga aktet e dëmshme si dhe përcakton tutje të drejtat e sinjalizuesve me rastin e denoncimit të një keqbehjeje. Ky udhëzues përbëhet nga tre pjesë, ku pjesa e parë i referohet krijimit dhe mbajtjes së një sistemi të brendshëm konfidencial dhe të sigurt të menaxhimit të sinjalizimit në institucione, pjesë e dytë i referohet mbrojtjes së sinjalizuesve nga veprimet e dëmshme, duke përfshirë krijimin dhe mirëmbajtjen e një mekanizimi të sigurt për t'iu përgjigjur ankesave dhe veprimeve të dëmshme, ndërsa pjesa e tretë flet për mbrojtjen gjyqësore për shqyrtimin e rasteve që përfshijnë sinjalizues ose persona të lidhur me sinjalizues.

Është e rëndësishme të theksohet se këta dy udhëzues nuk zëvendësojnë LMS ose Rregulloren por qëllimi i këtyre udhëzuesve është të shpjegojë kërkesat e LMS dhe Rregullores në mënyrë më praktike, si dhe të lehtësojnë zbatimin në praktikë të kërkesave ligjore në lidhje me mbrojtjen e sinjalizuesve dhe raportimin në interes publik.

KDI në përputhje me misionin e saj për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit ka dhënë kontribut në hartimin e LMS dhe rregullores por edhe në lehtësimin e zbatimit të këtij ligji në praktikë. Në këtë drejtim, së bashku me partnerët nga Transparency International në Holandë ka përpiluar një Komentari të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve me qëllim parësor për të ndihmuar autoritetet private/publike në zbatimin e këtij ligji duke përcaktuar kuptimin e secilës dispozitë dhe procedurën e nevojshme për zbatimin e tij.

Ky Komentari i drejtohet kryesisht komunitetit të punonjësve në sektorin publik dhe privat, të cilët mund të përballen me shkelje të natyrave të ndryshme dhe që kanë vullnetin për t'i sinjalizuar ato. Duke ditur përmbajtjen dhe kuptimin e dispozitave ligjore, komuniteti i punonjësve do të krijojë siguri në lidhje me procedurën e njoftimit si dhe mbrojtjen e tyre nga pasojat e mundshme që mund të vijnë si pasojë e sinjalizimit. Por në të njëjtën kohë, ky Komentari do të shërbejë si një instrument i dobishëm për zyrtarët përgjegjës, institucionet publike, subjektet private që lidhen me zbatimin e këtij ligji.

11 Udhëzuesi për mbrojtjen e personave që raportojnë në interes publik, detyrimet e punëdhënësve për të mbrojtur sinjalizuesit nga aktet e dëmshme dhe të drejtën e sinjalizuesve për mbrojtje gjyqësore i miratuar nga Ministria e Drejtësisë me Vendimin Nr.179/2023 të datës 19.09.2023.



ZBATIMI I LIGJIT PËR SINJALIZIM NË DIKASTERET E QEVERISË

Gjetjet kryesore:



I. Mos-publikimi i emrave të zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim



II. Mos-shtrirja e informatës për punonjësit e institucioneve mbi mundësinë e sinjalizimit



III. Mungesa e kushteve teknike për të sinjalizuar brenda institucioneve



IV. Zyrtarët për sinjalizim kanë kaluar vetëm në trajnime bazike



V. Mungesa e përkrahjes institucionale për zyrtarët përgjegjës për sinjalizim



VI. Punë shtesë pa pagesë



VII. Mungesa e rasteve të sinjalizimit në institucione ndonëse parregullsitë janë evidente



I. Mos-publikimi i emrave të zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim

Çdo punëdhënës publik (institucion publik) është i obliguar të publikojë në ueb faqe të tij udhëzime në lidhje me sinjalizimin.¹² Gjithashtu në faqet zyrtare të institucioneve duhet të figurojnë të dhënat dhe kontakti i personit përgjegjës për trajtimin e rasteve të sinjalizimit në kuadër të atij institucioni.¹³ KDI vlerëson se ky është hapi i parë dhe shumë i rëndësishëm që mundëson zbatimin e këtij ligji.

Hulumtimi ka gjetur se jo të gjitha ministratë në kuadër të Qeverisë së Kosovës kanë përmbushur obligimet e tyre ligjore në përputhje me publikimin e emrit dhe të dhënave të zyrtarit përgjegjës për sinjalizim në uebfaqen e tyre zyrtare. Për më tepër, duke vizituar uebfaqet zyrtare të 16 institucioneve (zyrës së Kryeministrit dhe ministrive) në shtator të vitit 2023, KDI ka gjetur se në nëntë (9) uebfaqe të institucioneve mungojnë të dhënat mbi zyrtarin përgjegjës për sinjalizim, ndërsa në vetëm shtatë (7) raste, janë paraqitur këto të dhëna. Edhe nga këto shtatë (7) raste ku gjejmë të dhëna mbi zyrtarin përgjegjës për sinjalizim në uebfaqen e institucionit përkatës, këto të dhëna nuk janë të plota. Në një rast është paraqitur vetëm emaili ku punonjësit mund të sinjalizojnë mirëpo mungon emri i zyrtarit përgjegjës ndërsa në rastin tjetër paraqitet vetëm emri i zyrtarit përgjegjës por mungon forma e kontaktit për zyrtarin.

KDI gjatë kohës së mbajtjes së intervistave dhe në vazhdimësi deri në publikimin e kësaj analize ka rishikuar uebfaqet e institucioneve nëse të njëjtat kanë pësuar ndonjë ndryshim sa i përket publikimit të emrave dhe kontakteve të zyrtarit përgjegjës për sinjalizim dhe ka gjetur se dy (2) ministri, përkatësisht Ministria e Mbrojtjes (MM) dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) kanë bërë publike në uebfaqet e tyre, emrat dhe kontaktet e zyrtareve përgjegjës për sinjalizim. Gjithashtu një ndryshim pozitiv shënon edhe Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike (MPBAP), e cila në kohën e mbajtjes së intervistës ka pasur publik emrin e zyrtarit përgjegjës për sinjalizim mirëpo qasja në të ka qenë e kufizuar, ndërsa pas mbajtjes së intervistës, ministria në fjalë ka vendosur në kryefaqen e institucionit një vegzë që i drejtohet sinjalizimit duke e bërë shumë të lehtë për punonjësit apo publikun gjetjen e emrit të zyrtarit për sinjalizim në këtë institucion.

12 Neni 6, par.2, i Rregullores nr. 03/2021 për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit

13 Po aty, neni 6, par.3.2



II. Mos-shtrirja e informatës për punonjësit e institucioneve mbi mundësinë e sinjalizimit

LMS ka përcaktuar që institucionet publike e private, me qëllim të informimit dhe vetëdijesimit të punonjësve të tyre lidhur me sinjalizimin dhe procedurat e sinjalizimit, janë të obliguar të sigurojnë udhëzime me shkrim për punonjësit e tyre.¹⁴ Madje këto udhëzime apo informacione tjera të dobishme duhet të publikohen në uebfaqet e institucioneve, të përditësohen dhe shpërndahen rregullisht tek punonjësit, kur është e mundur teknikisht.

Për më tepër rregullorja përcakton se zyrtari përgjegjës ndërmerr veprime për t'ua lehtësuar punonjësve raportimin për parregullsitë apo keqpërdorimet brenda atij institucioni e që janë në interes publik. Kjo përfshin vendosjen dhe shpërndarjen e formularëve për paraqitjen e raportimeve brenda institucionit, publikimin e këtij formulari në uebfaqen zyrtare të institucionit si dhe vendosjen e informatave se si një sinjalizues mund të kontaktoj zyrtarin përgjegjës për të dorëzuar një raportim në interes publik.

Mos përmbushja e këtij obligimi sipas LMS ka për pasojë shqiptimin e gjobave dhe atë prej pesëqind (500) euro deri në njëzetmijë (20.000) euro për institucionin publik, subjektin privat si dhe autoritetin kompetent përkatës.¹⁵

Ashtu siç edhe u përmend me herët, KDI ka gjetur se në shumicën e uebfaqeve të ministrive kanë munguar informatat në lidhje me zyrtarin përgjegjës për trajtimin e rasteve të sinjalizimit. Megjithatë, këto institucione kanë bërë përpjekje të informojnë stafin e tyre për personin që është caktuar të ushtrojë detyrën e zyrtarit përgjegjës për sinjalizim. Së paku 9 nga 14 zyrtarët e intervistuar kanë raportuar se institucionet ku ata kryejnë detyrën e zyrtarit përgjegjës, kanë dërguar email njoftues tek të gjithë punonjësit dhe kanë ofruar kontaktet e zyrtarit përgjegjës për trajtimin e rasteve të sinjalizimit.

Nga intervistat e zhvilluara me zyrtarët përgjegjës për trajtimin e rasteve të sinjalizimit, KDI është njoftuar se punonjësit e ministrive kanë fare pak informata mbi sinjalizimin përkundër që ata janë informuar me anë të emailit. Madje një prej zyrtarëve të intervistuar deklaroi se: *"prej që jam caktuar askush nga kolegët nuk më ka pyetur mbi këtë rol ose se çka është sinjalizimi... nuk e besoj që ka të bëjë më shumë se interesim se realisht kolegët flasin për parregullsi në institucion krejt kohën, në zyrë apo në kafe... por askush nuk vjen tek unë të sinjalizoj".* Ky zyrtar aludon që arsyeja kryesore që nuk ka pranuar ndonjë rast sinjalizimi qëndron në mosinformimin e kolegëve mbi këtë koncept, sepse, citon: *"sikur ata të dinin të drejtat dhe mbrojtjen që ligji u garanton sinjalizuesve, ata do të vinin të sinjalizonin tek unë... e jo ndoshta të flisnin cepave të zyrave... por ja që ministria s'ka punuar fare në drejtim të promovimit të këtij ligji".*

Si përfundim, KDI vlerëson se institucionet në nivelin ekzekutiv janë mjaftuar me caktimin e zyrtarëve përgjegjës për trajtimin e rasteve të sinjalizimit, ndërkohë që përpjekjet e tyre për të informuar punonjësit e tyre për procedurat e sinjalizimit dhe të drejtat që burojnë nga ky ligj kanë qenë minimale.

¹⁴ Neni 28, i Ligjit nr. 06/L -085 për mbrojtjen e sinjalizuesve

¹⁵ Po aty, neni 27



III. Mungesa e kushteve teknike për të sinjalizuar brenda institucioneve

LMS ka përcaktuar se zyrtari përgjegjës është personi i caktuar nga institucioni publik apo subjekti privat për të pranuar dhe trajtuar sinjalizimin.¹⁶ Sipas rregullores, zyrtarit përgjegjës duhet t'i sigurohen burime të mjaftueshme për të përmbushur detyrat e tij, përfshirë hapësirë dhe pajisje për punë, si dhe kushte të përshtatshme për ruajtjen e dokumenteve.¹⁷ Për më tepër udhëzuesi për mbrojtjen e sinjalizuesve, i cili rishtazi është aprovuar përcakton obligimin e institucioneve që të i sigurojnë zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim mjete për të ruajtur në mënyrë të sigurt dosjet e çështjeve, si sigurimin e një kasaforte apo të dollapëve të çelikut.¹⁸ Për më tepër, LMS ka paraparë se zyrtari përgjegjës dhe çdo person tjetër i cili pranon apo përpunon raportime në interes publik gjatë kryerjes së detyrës zyrtare duhet të ruajë në çdo kohë në mënyrë konfidenciale informacionin lidhur me sinjalizimin, duke mos e përhapur ose transmetuar tek persona të tretë brenda ose jashtë institucionit, si dhe të mos e përdorin për qëllime të tjera.¹⁹ Madje, Rregullorja përcakton se mosrespektimi i konfidencialitetit nga zyrtari përgjegjës dhe çdo personi tjetër i cili pranon raportime në interes publik do të konsiderohet si shkelje e detyrave të punës.²⁰

Hulumtimi i KDI-së ka gjetur se shumica e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim nuk kanë kushte të përshtatshme të punës për të trajtuar rastet e sinjalizimit. KDI ka gjetur se 11 nga 14 zyrtarët e intervistuar, ndajnë të njëjtin ambient pune me kolegët e tyre dhe nuk disponojnë zyra të ndara. Në shumicën e ministrive ekziston koncepti i zyrave të hapura të punës, që do të thotë se shumica e zyrtarëve të caktuar për sinjalizim në ministri ndajnë një ambient pune me 20 deri në 30 zyrtarë të tjerë. Kjo situatë është cilësuar problematike edhe nga vetë zyrtarët për sinjalizim të intervistuar, të cilat kanë zbuluar se kurdo herë që një koleg i tyre dëshiron të sinjalizojë ata detyrohen të kalojnë në ndonjë sallë apo zyre tjetër të lirë apo ndoshta të caktojnë një takim edhe jashtë ambienteve të ministrisë, në mënyrë që të mos komprometojnë identitetin e sinjalizuesit.

KDI nga intervistat e zhvilluar ka gjetur se institucionet përveç që nuk ju kanë ofruar ambiente të ndara të punës, zyrtarëve të caktuar për sinjalizim, gjithashtu nuk ju kanë siguruar edhe mjete të punës konform kërkesave ligjore. Kësisoj asnjë nga zyrtarët e sinjalizuar nuk ka dollap të veçantë të çelikut apo kasafortë, të destinuar për mbajtjen e shkresave dhe dokumenteve në lidhje me sinjalizimet

ndërsa problematike mbetet edhe përdorimi i mjeteve të tjera të punës si, kompjuterët apo printerët me qasje të përbashkët. Kësisoj një nga zyrtarët për sinjalizim të intervistuar ka deklaruar se printeri ku printon shkresat që pranon nga raportuesit në interes publik është në shërbim dhe në të kanë qasje edhe rreth 30 zyrtarë tjerë. Kësisoj zyrtari për sinjalizim deklaroi se "kurdo që pranoj raportime të cilat më duhet të kem edhe si kopje fizike, e kam shumë të vështirë të ruaj konfidencialitetin e palës, e shpesh detyrohem të qëndroj afër printerit nga frika se një zyrtarë tjetër mund të ketë qasje në ato shkresa".

KDI vlerëson se në përgjithësi institucionet në nivelin ekzekutiv kanë dështuar t'u sigurojnë zyrtarëve përgjegjës për pranimin e rasteve të sinjalizimit ambiente të përshtatshme të punës dhe mjete e nevojshme për kryerjen e kësaj detyre të re konform obligimeve që dalin nga LMS.

16 Po aty, neni 3, par. 1.10

17 Neni 5.9, i Rregullores nr. 03/2021 për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit

18 Ruajtja dhe trajtimi i sigurt i të dhënave (1.1.9). Udhëzuesi për mbrojtjen e personave që raportojnë në interes publik, detyrimet e punëdhënësve për të mbrojtur sinjalizuesit nga aktet e dëmshme dhe të drejtën e sinjalizuesve për mbrojtje gjyqësore i miratuar nga Ministria e Drejtësisë me Vendimin Nr.179/2023 të datës 19.09.2023, fq.15.

19 Neni 11, i Ligjit nr. 06/L -085 për mbrojtjen e sinjalizuesve

20 Neni 7, i Rregullores nr. 03/2021 për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit





IV. Zyrtarët për sinjalizim kanë kaluar vetëm në trajnime bazike

Kompleksiteti i detyrave që u është deleguar zyrtarëve përgjegjës për trajtimin e rasteve të sinjalizimit, kërkon që ata fillimisht të pajisen me njohuri adekuate ligjore e praktike mbi këtë çështje. Rregullorja në fuqi përcakton obligimin ligjor për institucionet përkatëse për të ofruar trajnime për zyrtarët për sinjalizim ndërsa mandaton APK që sipas kërkesës së institucioneve publike të përgatisë programin e trajnimeve për zyrtarët përgjegjës për trajtimin e rasteve të sinjalizimit.²¹

Vetë sinjalizimi përbën një koncept të ri ndërsa LMS konsiderohet të jetë një paradigmë ligjore e pa eksploruar sa duhet në fushën kundër korrupsion. Si i tillë, zbatimi efikas i tij kërkon një vullnet dhe përkushtim shumëdimensional dhe paraqet një sfidë për institucionet publike e private. Zbatimi i ligjit është i lidhur drejtpërdrejt me kapacitetin e zyrtarëve përgjegjës në institucionet publike e private për të trajtuar në mënyrë profesionale e adekuate rastet e sinjalizimit. Për këtë, trajnimet kualitative dhe të mjaftueshme për zyrtarët përgjegjës për sinjalizimin duhet të jenë në plan të parë në mënyrë që të sigurojnë zbatueshmërinë e këtij ligji.

Intervistat e realizuara me zyrtarët përgjegjës për sinjalizim në nivelin ekzekutiv kanë treguar se të këta zyrtar u janë nënshtruar së paku një trajnimi bazik mbi sinjalizimin që nga momenti kur kanë pranuar këtë detyrë. Megjithatë të gjithë zyrtarët e intervistuar kanë deklaruar se kanë nevojë për trajnime shtesë, kjo marrë parasysh se korniza ligjore rreth mbrojtjes së sinjalizuesve ka pësuar ndryshim dhe është detajuar tutje me hyrjen në fuqi edhe të dy (2) udhëzuesve. Për më tepër shumica e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim të intervistuar, konsiderojnë se trajnimet që ata kanë mbajtur rreth detyrës së re janë jo adekuate, kanë përmbajtjen e njëjtë dhe janë të fokusuar vetëm në shpjegimin e kornizës ligjore, pa shembuj praktik për menaxhimin e një raportimi.

Një nga zyrtarët për sinjalizim ka deklaruar se “...vetëm shpjegimi i koncepteve ligjore nuk duhet të përkthehet edhe në zbatim të mirë të ligjit nga ana jonë. Ne kemi nevojë edhe për shembuj praktikë dhe situata nga jeta reale për të kuptuar saktë se si duhet të pranojmë dhe hetojmë një rast të sinjalizimit”.

KDI vlerëson se trajnimet që ju ofrohen zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim duhet të përkojnë me ndryshimet dhe plotësimet ligjore si dhe duhet të ju përshtaten kërkesave dhe nevojave të zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim. Gjithashtu këto trajnime nuk duhet të anashkalojnë pjesën praktike të zbatimit të LMS meqë përfshirja e raste praktike në trajnime, ndikon në përmisimin e praktikave të mira rreth zbatimit adekuat të këtij ligji.

21 Po aty, neni 5, par.12, i Rregullores nr. 03/2021 për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit





V. Mungesa e përkrahjes institucionale për zyrtarët përgjegjës për sinjalizim

Hulumtimi i KDI ka gjetur se të gjithë zyrtarët përgjegjës për sinjalizim në nivelin ekzekutiv janë caktuar nga eprorët e tyre pa ndonjë konsultim paraprak dhe pa marrë pëlqimin e tyre. Shumica nga ta kanë deklaruar se vendimin për caktimin e tyre si zyrtarë përgjegjës për sinjalizim e kanë marrë vetëm përmes email, pa u ofruar mundësi që të diskutojnë mbi një refuzim të mundshëm të detyrës. Për më tepër është vërejtur se këto detyra u janë deleguar zyrtarëve të profileve të ndryshme e që kanë përgatitje të ndryshme profesionale. Përkundër se legjislacioni në fuqi nuk përcakton kritere të qarta në lidhje me profilin e zyrtarit përgjegjës për sinjalizim, rekomandohet që nëse institucioni ka një zyrtar të caktuar për etikë, politikat e luftimit të korrupsionit ose çështjet e ndërlidhura, i njëjti zyrtar mund të caktohet si zyrtar përgjegjës.²²

Të gjithë zyrtarët e intervistuar deklarojnë se në momentin kur janë njoftuar me detyrën e re, ata nuk kanë pranuar instruksione apo materiale, qoftë ligjin apo rregulloren apo ndonjë material tjetër orientues në lidhje me këtë detyrë të re.

Shumë nga zyrtarët përgjegjës për sinjalizim të intervistuar kanë deklaruar se përveç pozitës primare ushtrojnë edhe pozita të tjera brenda të njëjtit institucion. Një zyrtar përgjegjës për sinjalizim i intervistuar nga KDI, ka deklaruar se përveç pozitës primare që ushtron në institucion, atij i është caktuar edhe pozita e zyrtarit përgjegjës për sinjalizim, pozita e zyrtarit për qasje në dokumente publike dhe pozita e zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale. Pra nuk janë të pakta rastet kur zyrtarët e caktuar për sinjalizim kanë edhe 2-3 detyra shtesë, që sipas zyrtarëve ju ka krijuar vështirësi edhe në përmbushjen e obligimeve që kanë sipas pozitës primare. Një nga zyrtarët për sinjalizim ka deklaruar për KDI se “në momente të caktuara kam menduar të lëshoj vendin e punës për shkak të presionit dhe ngarkesës në punë”.

Nga intervistat me zyrtarët përgjegjës për sinjalizim në nivelin ekzekutiv është kuptuar se këta zyrtarë shpesh përballen edhe me sfida në ushtrimin e kësaj detyre, për vetë faktin që mbajnë këtë pozitë. Një nga zyrtarët ka deklaruar se për shkak të një rasti të sinjalizimit që ka pranuar në institucionin ku punon dhe që ka rezultuar në eliminimin e favorizimit në një procedurë përzgjedhje brenda institucionit, ai ka pësuar me dëmtim reputacioni ndërsa ka dëgjuar se është hapur edhe një rast gjyqësor ndaj tij.

Pra punonjësi ndaj të cilit janë marrë masa për shkak se ka favorizuar kolegë të caktuar përgjatë përzgjedhjes në komisione brenda institucionit, ka përndjekur dhe ngacmuar zyrtarin për sinjalizim në shenjë hakmarrje për masat që janë shqiptuar ndaj tij si pasojë e rekomandimit të zyrtarit për eliminim të parregullsive. Zyrtari për sinjalizim deklaroi se “janë dërguar disa ankesa tek sekretari i ministrisë mbi punën time dhe kam dëgjuar edhe fjalë tek kolegët e tjerë që ky person ka përhapur mbi mu”. Zyrtari i intervistuar nga KDI deklaroi se nuk ka pasur kurrfarë mbështetje nga institucioni në lidhje me këtë rast, ndërsa ende vazhdon të përballlet me pasojat e këtij rasti që padyshim që ka ndikuar në reputacionin e tij si zyrtar por edhe i janë shkaktuar shpenzime ligjore në raport me ankesat dhe veprimet e tjera gjyqësore që janë ndërmarrë nga kolegu i tij.

KDI nga intervistat e zhvilluar në institucionet në nivelin ekzekutiv ka gjetur se institucionet nuk kanë marrë parasysh nevojat dhe volumnin e punëve të zyrtarëve me rastin e caktimit të tyre në pozitën e zyrtarëve për sinjalizim si dhe nuk kanë mekanizma për të ju ofruar mbështetje qoftë ligjore apo tjetër ndaj këtyre zyrtarëve, në rastet kur të njëjtin përballen me sfida në kryerjen e detyrës së tyre.

22 Po aty, neni 5, par.2, i Rregullores nr. 03/2021 për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit



VI. Punë shtesë pa pagesë

Korniza ekzistuese ligjore, LMS, rregullorja dhe udhëzimet në lidhje me mbrojtjen e sinjalizuesve nuk përfshijnë dispozita për kompensimin e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim. Megjithatë, në intervistat me këta zyrtar brenda institucioneve të nivelit ekzekutiv, është shfaqur një shqetësim i përbashkët lidhur me mungesën e kompensimit për këtë rol.

Siç është identifikuar nga KDI përmes këtyre intervistave, një ndjenjë mbizotëruese në mesin e zyrtarëve është se roli i një zyrtari sinjalizues kërkon përkushtim të konsiderueshëm. Ata zyrtarë që kanë përvojë të drejtpërdrejtë në trajtimin e rasteve të sinjalizimit kanë theksuar kohën dhe angazhimin e nevojshëm për trajtimin e një rasti, duke përfshirë hetimin administrativ, komunikimin me palët përkatëse, ekzaminimin e dokumenteve, shqyrtimi e kornizës ligjore dhe përgatitjen e raporteve. Zyrtarët për sinjalizim theksojnë se ky angazhim mund të jetë disa-ditorë, qoftë edhe për një rast të vetëm. Ngarkesa e shtuar e punës bëhet veçanërisht e rëndë kur zyrtarët marrin sinjalizime në numër më të madh brenda një periudhe, kjo marrë parasysh përgjegjësitë e tyre ekzistuese brenda institucioneve.

Intervistat e KDI-së zbulojnë një kërkesë të gjerë për kompensim nga zyrtarët përgjegjës për sinjalizimin. Edhe gjatë trajnimeve të zhvilluara nga subjekte si APK apo institucione të tjera, këta zyrtarë vazhdimisht shprehin nevojën për kompensim në njohje të detyrës shtesë që u është ngarkuar. Një zyrtar i intervistuar theksoi se detyra e zyrtarit përgjegjës për sinjalizim nuk është një favor personal dhe theksoi rëndësinë e njohjes së sfidave dhe stigmës që lidhet me këtë rol duke ju mundësuar ndonjë formë të kompensimit apo përfitimit për zyrtarët që kryejnë këtë detyrë.

Për më tepër, intervistat hedhin dritë mbi një sugjerim specifik për kompensim. Përderisa shpërblimi financiar mund të jetë sfidues, zyrtarët propozojnë që një alternativë mund të jetë sigurimi i një ose dy dite shtesë pushimi me pagesë si kompensim për kryerjen vullnetare të kësaj detyre shtesë për institucionin. Ky propozim buron nga të kuptuarit se kompensimi i zyrtarëve për përpjekjet e tyre në fushën e sinjalizimit është thelbësor, duke pasur parasysh sfidat unike që ata hasin në ekzekutimin e detyrave të tyre.



VII. Mungesa e rasteve të sinjalizimit në institucione ndonëse parregullsitë janë evidente

Korniza ligjore për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit ka përcaktuar obligime ligjore për institucionet me qëllim që të fuqizoj dhe promovojë luftën kundër korrupsionit përmes raportimit në interes publik.

Megjithatë, KDI përmes intervistave me zyrtarët përgjegjës për sinjalizimin ka gjetur se numri i sinjalizimeve në institucionet në nivelin ekzekutiv mbetet ende shumë i ulët. Kësisoj 8 nga 14 zyrtarët për sinjalizim të intervistuar nga KDI apo 60% e tyre kanë deklaruar se nuk ka pranuar asnjë raportim nga ana e kolegëve të tyre. Ndërsa zyrtarët e tjerë që kanë pasur mundësinë të trajtojnë raste të sinjalizimit brenda institucioneve të tyre flasin se përkundër pranisë të parregullsive që janë evidente sepse përfliken në qarqe brenda institucioneve publike në vend apo edhe në media, numri i raportimeve që ata marrin është relativisht i ulët.

Madje një nga zyrtarët për sinjalizim flet hapur për praninë e korrupsionit në institucionin që përfaqëson, ndërsa deklaroi se *"Korrupsion ka, sidomos në prokurim, mirëpo sinjalizuesit mungojnë"*. Si faktor kryesor se pse numri i sinjalizuesve në institucionet në nivelin ekzekutiv mbetet i kufizuar është edhe mungesa e promovimit dhe ndërgjegjësimin midis sinjalizuesve potencialë. Punonjësit brenda këtyre institucioneve duken të painformuar për konceptin e sinjalizimit dhe kanalet e disponueshme të raportimit. Kjo mungesë njohurish vepron si një pengesë e rëndësishme, duke penguar përdorimin efektiv të sinjalizimit si një mjet për të ekspozuar dhe luftuar korrupsionin brenda proceseve të brendshme në institucione. Në thelb, mospërdorimi i sinjalizimit mund t'i atribuohet, të paktën pjesërisht, një hendeku në ndërgjegjësimin dhe promovimin brenda organizatave të nivelit ekzekutiv. Adresimi i këtij deficiti informativ shfaqet si një hap vendimtar në nxitjen e një kulture transparence dhe llogaridhënieje përmes sinjalizimit në institucione.

Faktor tjerë shtesë që zyrtarët për sinjalizim konsiderojnë se kanë ndikuar në numrin e ulët të raportimeve janë edhe mungesa e kushteve teknike për të sinjalizuar, pra frika nga zbulimi i identitetit të sinjalizuesit, pastaj mungesa e besimit në efektivitetin e sistemit përkatësish në trajtimin e një parregullsive në një mënyrë adekuate si dhe mungesa e mbrojtjes ligjore dhe mekanizmave tjerë mbështetës për sinjalizuesit potencial.





REKOMANDIMET

- Institucionet në nivelin ekzekutiv duhet të publikojnë në uebfaqet e tyre zyrtare të dhënat e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim, emrin dhe kontaktin e zyrtarit, në mënyrë që punonjësit por edhe publiku të kenë qasje në këto kontakte.
- Rregullorja duhet të përcaktojë kritere minimale mbi profilet apo pozitat adekuate që duhet të kenë personat që emërohen për të ushtruar pozitën e zyrtarit përgjegjës për sinjalizim.
- Institucionet në nivelin ekzekutiv të ofrojnë kushte fizike dhe teknike të përshtatshme për sinjalizim brenda hapësirave të tyre në mënyrë që sinjalizuesve t'u mbrohet identiteti dhe konfidencialiteti, në përputhje me ligjin por edhe zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim të ju mundësohen kushte të dinjitetshme të punës për trajtimin e duhur të rasteve të sinjalizimit.
- APK të organizojë programe trajnimi të vazhdueshme për zyrtarët e përgjegjës për sinjalizim në përputhje me ndryshimet ligjore, kërkesat dhe nevojat e zyrtarëve për trajnime duke mos anashkaluar edhe pjesën praktike të trajtimit të rasteve të sinjalizimit nga jeta reale.
- Institucionet në nivelin ekzekutiv duhet të promovojnë kulturën e raportimit të keqpërdorimeve në interes publik si vlerë në mbrojtjen e integritetit të institucioneve si dhe të punojnë në drejtim të informimit të mirëfilltë të stafit të tyre mbi sinjalizimin, të drejtat e sinjalizuesve dhe mënyrën e raportimi qoftë përmes broshurave apo posterave informuese, apo mbajtjes së takimeve joformale me stafin, për të diskutuar mbi konceptin e sinjalizimit.
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit duhet të jetë më proaktive në monitorimin e kërkesave ligjore që burojnë nga Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, si dhe në promovimin e sinjalizimit si mjet për luftimin e korrupsionit brenda institucioneve publike në vend.





PYETËSORI NË LIDHJE ME ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE - KDI

1 Kur e keni marrë detyrën si përgjegjës për trajtimin e rasteve të sinjalizimit?

2 A ndiheni profesionalisht të përgatitur për të ushtruar këto detyra që u janë ngarkuar?

1 mjaftueshëm 2 jo mjaftueshëm 3 aspak

3 A jeni trajnuar për këtë? Nëse po, Kur dhe nga Kush?

4 Çfarë materiale ju kanë dhënë në dispozicion (Ligjin, Rregullorja, Komentari etj)?

5 Sa është shtrirë informata në institucionin ku ju punoni për rolin tuaj?

6 Si është komunikuar kjo me stafin (email, telefon, mbledhje...)?

7 A ka pasur ndonjë rast sinjalizimi që ju keni trajtuar? Nëse Po, Kur?

8 A u është drejtuar ndonjë punonjës në institucionin tuaj me kërkesë për ndonjë informatë rreth sinjalizimit?

9 A keni ambient të përshtatshëm për takime me palë (sinjalizues)?

10 A keni nevojë për trajnime shtesë?

11 Cilat kanë qenë vështirësitë (sfidat) tuaja, nëse ka pasur?

12 A ka ndikuar detyra shtesë e zyrtarit për sinjalizim në përmbushjen e detyrave të punës?



KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI-së, ju lutem vizitoni:
www.kdi-kosova.org

Me përkrahjen financiare nga
Ministria Federale e Punëve të
Jashtme e Gjermanisë



RAPORTO KORRUPSIONIN

THIRR

**0800
77 777**

ose online në linkun
<https://raporto.kdi-kosova.org/>

**KORRUPSIONI
PAMUNDËSOHET
KUR RAPORTOHET**